



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 20438/Prot.

Lezhë, më 21 / 01 /2025

PROCES-VERBAL

Titulli i Projekt-aktit:KONSULTIM PUBLIK NË LIDHJE ME HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR NË EKONOMINË PYJORE “MALI I RRENCIT”

Data dhe vendi i mbajtjes së takimit: 21.01.2025, ora 10:00, në ambjentet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Gjergj Lacaj” LEZHË

Pjesëmarrësit në takim nga ana e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore:

1. Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave Z. Artan Palushi
2. Administrator i Njesisë Administrative Shëngjin Z. Brahim Demi
3. Sekretari i Këshillit Bashkiak Znj.Florida Çunaj.
3. Anëtare të Këshillit Bashkiak Z. Alfons Trashaj, Znj. Gjuljana Seferaj, Z. Zek Doda.

Territori që mbulon konsultimi publik:Sipas dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritëpërkatese dhe të përcjellura nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,objektet e parashikuara për ndërtimbëjnë pjesë në ngastrat pyjore numër 62a , 62c si dhe 49a të Ekonomisë Pyjore “Mali i Rrencit”, Shëngjin, Bashkia Lezhë dhe në pasurinë private numër 809, zonë kadastrale 2569 dhe pasuritë më numër 1000/35 , 1004/2 dhe 1004/4 në zonën kadastrale 2568.

Numri i Personave që marrin pjesë në takim: 44

Sipas list-prezencës janë shënuar 24 veta të pranishëm, ndërsa sipas fotografive të shkrepura gjatë takimit numërohen 44 persona të pranishëm.

Numri i femrave që marrin pjesë në takim: 17femra

Çështja 1 për diskutim:Procedura e heqjes nga fondi pyjor kombetar i siperfaqeve qe preken nga ndertimi

Shoqëritë “JUNIK” SHPK, “PRINCE ADRIATIK RESORT” SHPK si dhe “PRINCEJUNIOR” SHPK kanë paraqitur kërkesën online pranë Ministrisë së Turizmit dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mjedisit, për heqje nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqeve , ku sipas Vendimit të KKT-së do ndërtohen objektet e parashikuara.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020“Për Pyjet”, si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes.Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet shkresave numër 7520 protokoll datë 02.12.2024 dhe numër 7986 protokoll datë 19.12.2024 i është drejtuar Bashkisë Lezhë për hartimin e Raportit Tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë me vendim të Këshillit Bashkiak për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes që preket nga gjurma e ndërtimit, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III të VKM-së numër 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.

Nga ana e Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë, është përgatitur raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që preken nga gjurma e ndërtimit.

Çështja 2 për diskutim:

Drejtori i Kompanisë Z. Arben Doda sqaroi iniciativën e kompanisë për të zhvilluar zonën nëpërmjet strukturave akomoduese që do të ndërtohen në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë.

Kompanitë aplikante për heqjen nga fondi pyjor kombëtar kanë marrë leje ndërtimi nga KKT-ja dhe do të kryejnë të gjithë procedurën dhe hapat e ndërtimit të objekteve sipas Lejes së ndërtimit, pasi të jetë hequr nga fondi pyjor si dhe do të kryejë rehabilitimin mjedisor sipas legjislacionit në fuqi.

Konkluzione nga takimi:

Nga ana e të pranishmëve nuk pati asnjë diskutim apo vëretje kundra zhvillimit të zonës dhe procedurës së heqjes nga fondi pyjor kombëtar.

Struktura përgjegjëse

për mbajtjen e process-verbalit :

ARTAN PALUSHI

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

FLORIDA ÇUNAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË





REPUBLIKA E SHQIPËRIË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

